



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Financave dhe Ekonomise



## KONTRATË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Sot, më datë ....../....../ 201\_, lidhet kjo kontratë midis palëve të poshtëshënuara:

**Bordi i Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare**, krijuar në bazë të Ligjit të Marrëveshjes së Licensimit të Lotarisë Kombëtare dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.192, datë 04/03/2015, i përfaqësuar ligjërisht nga Z./Znj. \_\_\_\_\_, Kryetar i Bordit me numër dokument identifikimi \_\_\_\_\_ në cilësinë e Financuesit

*Dhe*

\_\_\_\_\_, regjistruar si person fizik, juridik pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin Nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_ dhe me përfaqësues ligjor, Z./Znj. \_\_\_\_\_, me numër dokument identifikimi \_\_\_\_\_ në cilësinë e **Përfituesit**.

### **Neni 1 Baza ligjore**

Kjo kontratë lidhet në bazë të Ligjit të Marrëveshjes së Licensimit të Lotarisë Kombëtare dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 192, datë 04/03/2015

### **Neni 2 Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj Kontrate është financimi me fonde për zbatimin e Projektit:

“ \_\_\_\_\_ ”.

### **Neni 3 Periudha**

Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit, brenda një afati \_ (\_\_\_\_\_) mujor, siç parashikohet në Formularin e Aplikimit. Si moment i fillimit të zbatimit të projektit të përcaktuar në Nenin 2, do të konsiderohet dita e parë e javës së parë sipas Formularit të Kalendarit të Aktiviteteve të periudhës afatshkurtër ose afatgjatë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe që është pjesë integrale e saj.

### **Neni 4 Shuma e Financimit të Projektit**

Shuma totale për zbatimin e projektit është \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) lekë. Financuesi do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) lekë që përfaqëson \_\_\_\_\_ % (\_\_\_\_\_) përqind) të buxhetit total, dhe përfituesi ofron \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) lekë si pjesë e kontributit të tij, që përfaqëson \_\_\_\_\_ % (\_\_\_\_\_) përqind) të buxhetit total.

### **Neni 5 Mënyra e Financimit të Projektit (Tabela e Pagesave)**

Financuesi do të kryejë pagesën paraprake prej 50% të fondit për Përfituesin, jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e Vendimit për financimin e Projektit. Pjesa prej 40% e Fondit do të financohet 15 ditë pas miratimit të raportit afatmesëm dhe 10% pas miratimit të raportit final.

Raporti final përshkruet dhe financiar i cili do të dorëzohet me mbarimin e kohëzgjatjes totale të projektit.

Tabela e pagesave:

| Lloji         | Shuma që do të paguhet (ne Lekë)  | Kushtet                       | Afati për pagesën                                       |
|---------------|---|-------------------------------|---|
| Pagesa e parë | (50% e fondit të miratuar për financimin e pagesës paraprake të Projektit). | Firmosja e Kontratës          | 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të Kontratës        |
| Pagesa e dytë | (40% e fondit të miratuar).   | Miratimi i raportit Afatmesëm | 15 ditë kalendarike pas miratimit të raportit Afatmesëm |
| Pagesa Finale | (10 % e fondit të miratuar).  | Miratimi i Raportit Final     | 15 ditë kalendarike pas miratimit të raportit final     |

## Neni 6 Detyrimet e përfituesit

Përfituesi detyrohet:

- Të kryejë aktivitetet e përshkruara në Formularin e Aplikimit dhe duke respektuar afatet e përcaktuara në këtë fomular.
- Të shpenzojë fondet sipas zërave të buxhetit të miratuar, të paraqitur në Formularin e Aplikimit.
- T'i kthejë Financuesit të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të Projektit.
- T'i kthejë Financuesit brenda 7 ditëve pasi raporti final është shqyrtuar dhe miratuar, të gjitha fondet të cilat janë përdorur për të mbuluar shpenzimet që Bordi i Cështjeve të Mira nuk i ka miratuar.

## Neni 7 Raportimi

Për Projektin që financohet, objekt i kësaj Kontrate, Përfituesi duhet të dorëzojë Raportin Përshkruet bashkëlidhur keësaj kontrate si Aneks 1 si dhe Raportin Financiar bashkëngjitur kësaj kontrate si Aneks 2.

Raportimi për projektet e financuara bëhet sipas periudhave, si më poshtë vijon:

- a) Për projektet me afat më të shkurtër se 1 (një) vit, raportet financiare dhe teknike paraqiten dy herë në përfundim të gjysmës së parë të projektit (afatmesëm) dhe në fund të projektit (final).
- b) Për projektet që zgjasin më shumë se 1 (një) vit, raportet për vitin e dytë dhe më tej paraqiten çdo 6 (gjashtë) muaj.

Raporti Financiar duhet të plotësohet sipas formatit të miratuar nga Financuesi (Aneks 2 i kësaj kontrate) dhe nënshkruhet nga Përfaqësuesi Ligjor i Përfituesit.

Raporti Përshkruet duhet të plotësohet sipas formatit të miratuar nga Financuesi (Aneks 1 i kësaj kontrate) dhe duhet të shoqërohet me jo më pak se 5 (pesë) kopje të çdo publikimi të realizuar në kuadër të aktiviteteve të projektit por edhe me fotografi apo filmime të aktiviteteve në të cilat duhet të pasqyrohet stema/ logo e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Lotarisë Kombëtare.

Ky raport nënshkruhet nga Përfaqësuesi Ligjor i Përfituesit ose personi i autorizuar prej tij me autorizim të posaçëm ose prokurë të posaçme ose të përgjithshme të cilat duhet të dorëzohen jo më vonë se 5 (pesë) ditë para dorëzimit të raportit përshkrues ose financiar.

Të gjitha raportet do të miratohen nga Financuesi brenda 15 ditëve kalendarike, që nga dita e dorëzimit nga përfituesi. Njësia monitoruese e Lotarisë Kombëtare, pjesë e Financuesit, ka të drejtë të kryejë verifikimin dhe kontrollin në vend të dy Raporteve të lartpërmendura.

#### **Neni 8**

##### **Të dhëna mbi llogarinë bankare të përfituesit:**

- a) Emri i Bankës së përfituesit : \_\_\_\_\_
- b) Numri i llogarisë bankare në lekë : \_\_\_\_\_
- c) Numri IBAN : \_\_\_\_\_

#### **Neni 9**

##### **Përgjegjësia e Përfituesit**

9.1 Përfituesi është subjekti përgjegjës për kryerjen me efektivitet të projektit sipas Formularit të Aplikimit.

9.2 Financuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

9.3 Përfituesi sipas rastit, duhet të dorëzojë aktin e vetëdeklarimit në formë zyrtare ku shprehet dhe deklaron se nuk lejon financimin e të njëjtit project/aktivitet/ iniciativë objektit i kësaj kontrate, me shuma të financuara nga buxheti i shtetit përveçse nga Bordi i Çështjeve të Mira

#### **Neni 10**

##### **Nënkontraktimi**

Përfituesi nuk lejohet të kryejë nënkontraktime për realizimin e aktiviteteve me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

#### **Neni 11**

##### **Monitorimi/Kontrolli**

Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, palët duhet t'i përgjigjen kërkesës së njëra tjetrës me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga dorëzimi i saj.

Përfituesi duhet t'i ofrojë akses në çdo kohë Njesisë së Monitorimit të Lotarisë Kombëtare, pjesë e Financuesit, pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit, për informacione dhe dokumente që lidhen me projektin dhe zbatimin e tij (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga Financuesi

Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 (tre) vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu është i detyruar t'i ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo auditi dhe monitorimi të Njesisë së Monitorimit të Lotarisë Kombëtare, pjesë e Financuesit, që ka kompetencë të kontrollojë shpenzimin e fondit.

#### **Neni 12**

##### **Publikimi**

Përfituesi duhet të vendosë logon e Ministrisë së Financës dhe të Lotarisë Kombëtare në të gjithë informacionin lidhur me aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të Financuesit, si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte të përgatitura në kuadër të projektit.

Në rastet e publikimit apo prezantimit publik të dokumenteve dhe materialeve të prodhuara në kuadër të projektit, përfituesi merr përsipër të vendosë pohimin e mëposhtëm: “Ky projekt është mundësuar me mbështetjen financiare të Bordit të Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i Bordit të Çështjeve të Mira”.

Me këtë kontratë, Përfituesi detyrohet t'i lejojë Financuesit të publikojë emrin e përfituesit, adresën, qëllimin e projektit, aktivitetet si dhe fondin e marrë, në çdo mënyrë që Financuesie konsideron të dobishme.

### **Neni 13**

#### **Pronësia e produkteve të projektit**

Të gjitha materialet e prodhuara në kuadër të projektit mbeten pronë e Përfituesit. Financuesi gëzon të drejtën e përdorimit të tyre sipas nevojës, duke patur parasysh kufizimet që rrjedhin nga legjislacioni mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.

Përfituesi duhet t'i dorëzojë Financuesit 5 (pesë) kopje për secilin publikim apo material të prodhuar në kuadër të projektit pranë Financuesit.

### **Neni 14**

#### **Ndryshimet e Kontratës**

Ndryshimet e rëndësishme në mënyrën/metodën dhe kohën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga Financuesi.

Zgjatja në kohë e projektit apo shkurtimi i tij ndodh vetëm pas një kërkesë nga Përfituesi e dërguar të paktën 1 (një) muaj përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Financuesi.

Financuesi njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë bankare të Përfituesit.

Ndryshimet në zërat buxhetorë lejohen deri në një total prej 5% të fondit të financuar nga Financuesi dhe mund të bëhen pa miratimin paraprak të Financuesit. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim Financuesin në raportin pasues.

Ndryshimi i menaxherit të projektit dhe i mbi 50% të ekipit të projektit duhet të miratohet paraprakisht nga Financuesi.

Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

### **Neni 15**

#### **Ndërprerja e Kontratës**

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

- Përfituesi për shkak të pajustificuara, nuk realizon aktivitetet në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
- Njësia e Monitorimit të Lotarisë Kombëtare, pjesë e Financuesit, që ka të drejtë të kontrollojë shpenzimet e fondit dhe realizimin e projektit, konstaton shkelje dhe kjo pranohet nga Bordi i Çështjeve të Mira.
- Ka Forca Madhore.

### **Neni 16**

#### **Shpenzime të lejueshme/të palejueshme**

16.1 Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit, ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit.

16.2 Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, nuk duhet të lidhen me funksionimin e përgjithshëm të Përfituesit dhe duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit.

Shpenzimet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to, nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e financuar për Projektin:

- Blerje e tokës
- Shit-blerje makinash
- Interes mbi huadhënie
- Rikonstruksion zyresh ku ushtron aktivitetin Përfituesi
- Marrëveshje huadhënie
- Amortizim/zhvlerësim të pasurive dhe mjeteve të Përfituesit
- Dhurime
- Financim i partive politike, sindikatave institucioneve fetare dhe organizatave politike
- Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.
- Veprime dhe aktivitete në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 17**

## **Sanksionet**

Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe përshkruese, sjell paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Në rastin e mospërbushjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet Financuesit.

Në rastin e konstatimit të nënkontraktimit/ve për realizimin e aktiviteteve të projektit, Përfituesi duhet të kthejë shumën/at e nënkontraktuar/a.

Në rastin kur dëmtohet cilësia e aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë Financuesit, shumën/at e përdorur/a për financimin e këtyre aktiviteteve dhe/ose materiale publikuese.

Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Fondi, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në Formularin e Aplikimit, shuma e shpenzuar jo në përputhje me zerat e buxhetit do t'i kthehet Financuesit dhe Përfituesi detyrohet të paguajë një gjobë prej 10% të Fondit të financuar nga Financuesi.

## **Neni 18 Zgjidhja e konflikteve**

Në rastet e mosmarrëveshjeve dhe mospërbushjes së detyrimeve nga palët, për çështjet e financimit, raportimit dhe monitorimit të zbatimit të projektit, objekt i kësaj kontrate, palët do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

## **Neni 19 Të ndryshme**

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.

Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 6 (gjashtë) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 5 (pesë) i mban Financuesi dhe 1 (një) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

### **Kjo kontratë nënshkruhet nga :**

Për Financuesin

Z./Znj. \_\_\_\_\_

Kryetar i Bordit të Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare.

Firma \_\_\_\_\_

Vula

Për Përfituesin:

\_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_

Vula

## **Aneks 1**

## Raporti Përshkrues

|                                 |         |   |                        |
|---------------------------------|---------|---|------------------------|
| <b>Titulli i Projektit:</b>     | “.....” | <b>Emri i Projektit:</b>                      | “.....”                |
| <b>Kohëzgjatja e Projektit:</b> | .....   | <b>Periudha e Raportimit/nr i raportimit:</b> | ..... 2015<br>Nr. .... |

|                  |                             |                             |  |
|------------------|-----------------------------|-----------------------------|--|
| <b>Financimi</b> | <b><u>Të përfituara</u></b> | <b><u>Të shpenzuara</u></b> | <b><u>Shpenzime të planifikuara për periudhën tjetër</u></b> |
|                  | lekë                        | lekë                        | lekë   |

|                               |                        |                       |
|-------------------------------|------------------------|-----------------------|
| <b>Ndryshimet<sup>1</sup></b> | <b><u>Kontrata</u></b> | <b><u>Buxheti</u></b> |
|                               |                        |                       |

|                         |                     |                            |                      |
|-------------------------|---------------------|----------------------------|----------------------|
| <b>Staf<sup>2</sup></b> |                     | <b><u>Nr. i Synuar</u></b> | <b><u>Aktual</u></b> |
|                         | Me kohë të plotë    |                            |                      |
|                         | Me kohë të pjesshme |                            |                      |
|                         | Vullnetarë          |                            |                      |
|                         | Të brendshëm        |                            |                      |

|  |          |                           |                      |
|--|----------|---------------------------|----------------------|
| <b>Përfituesit e Projektit<sup>3</sup></b> |          | <b><u>Nr i Synuar</u></b> | <b><u>Aktual</u></b> |
|  | Direkt   |                           |                      |
|  | Indirekt |                           |                      |

|  |  |  |
|--|--|--|
| <b>Aktivitetet (Workshop-e, Trajnime, shërbime apo Evente)<sup>4</sup></b> |  |  |
|--|--|--|

|                                  |                          |                           |                      |
|----------------------------------|--------------------------|---------------------------|----------------------|
| <b>Raportet &amp; Publikimet</b> |                          | <b><u>Nr i Synuar</u></b> | <b><u>Aktual</u></b> |
|                                  | Njoftime për shtyp/media |                           |                      |
|                                  | Publikime të ndryshme    |                           |                      |

### A. RESPEKTIMI I KONTRATËS

#### 1. Arritjet e deritanishme të projektit, a janë në përputhje me kërkesat e kontratës? Nëse jo, ju lutemi

<sup>1</sup> Ju lutemi jepni vetëm nr. e ndryshimeve të bëra. Sqarimin jeni të lutur ta shkruani brenda raportit përshkrues në pikën e kërkuar.

<sup>2</sup> Ju lutemi të plotësoni nr. e personave të cilët janë të përfshirë në këtë projekt të financuar nga Fondi i Bordit të Çështjeve të Mira.

<sup>3</sup> Përfituesit direkt zakonisht janë pjesmarrësit në projekt si psh workshop-e, apo individë të cilët marrin shërbimin nga Përfituesi. Përfituesit indirektë përfshin çdokënd i cili influencohet nga projekti juaj. Ju duhet të shkruani vetëm nr. e tyre në këtë tabelë, dhe sqarimin jeni të lutur ta bëni në pikën e kërkuar brenda raportit.

<sup>4</sup> Ju lutemi të përfshini në këtë seksion nr. e aktiviteteve të synuara siç parashikohet në projekt dhe nr. e aktiviteteve të realizuara deri në periudhën e raportimit.

shpjegoni si dhe pse kanë ndodhur ndryshimet?

2. A ka pasur ndryshime / lëvizje në buxhet gjatë kësaj periudhe?

## B. AKTIVITETET

1. Ju lutemi raportoni të gjitha aktivitetet e projektit që nga fillimi /ose që nga dorëzimi i raportit më të fundit, duke evidentuar të gjitha rezultatet e këtyre aktiviteve.
2. Nëse ka ndonjë ndryshim në planin e aktiviteve, ju lutemi raportoni dhe justifikoni ndryshimin.

- ❖ Muaji I
- ❖ Muaji II
- ❖ Muaji III

2. Çfarë problemesh janë hasur gjatë implementimit të projektit që nga fillimi i tij/ose që nga dorëzimi më i fundit i raportit të projektit, dhe si e keni zgjidhur atë?

*Problem 1*  
*Problem 2*  
*Problem 3*

3. Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e planifikuara për 6 –muajin e ardhshëm nëpërmjet tabelës së aktiviteve.

## C. IMPAKTI DHE VLERËSIMI

1. Si i vlerësoni ju rezultatet e arritura të projektit? Ju lutemi merrni në konsideratë të shpjegoni se në ç`nivele janë arritur objektivat e synuara të projektit dhe në ç`mënyrë kanë ndikuar ato tek target grupi (pozitiv apo negativ qofshin ato) .

- 1.
- 2.
- 3.

## D. VIZIBILITETI

2.Si e keni pasqyruar dhe reklamuar mbështetjen e Fondit të Çështjeve të Mira, si dhe përdorimin e logove të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Lotarisë Kombëtare?

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Përgatiti raportin: “.....”

Firma/vula

---

Drejtore Ekzekutive



EMRI I APLIKUESIT: \_\_\_\_\_  
 Projektit: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Data e Fillimit të Projektit: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Data e Mbarimit të

| FORMULARI I KALENDARIT TË AKTIVITETEVE |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|------------------|----------------|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| MUAJI I (_____)                        |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    | STAFI PËRGJEGJËS |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| AKTIVITETE                             | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31               | (Emër Mbiemër) |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| MUAJI II (_____)                       |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    | STAFI PËRGJEGJËS |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| AKTIVITETE                             | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31               | (Emër Mbiemër) |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| MUAJI III (_____)                      |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    | STAFI PËRGJEGJËS |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| AKTIVITETE                             | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31               | (Emër Mbiemër) |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |                  |                |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |

